

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 90 Rep.
Nr. 33 Kol.



AKT THEMELIMI

Ne Tirane, sot me date 25.01.2017, perpara meje noteres publike, Elmira KODRA, anetare e Dhomes se Noterise Tirane, u paraqiten personalisht shtetasit:

1. Antonio MANCA, i biri i Giuseppe, lindur me 13.06.1966, ne San Cesario di Lecce (LE), Itali, banues ne Guagnano, via "A de Gasperi", nr.18, shtetas italian, madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet kartes se identitetit italiane nr. AY 1660323;
2. Giuseppe SPAGNOLO, i biri i Cosimo, lindur me 28.07.1962, ne Brindisi (BR), Itali, banues ne San Pamcrazio Salentino, via "Calvario", nr.38, shtetas italian, madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet kartes se identitetit italiane nr. AU 5535581;

te cilet me cilesine e "Ortakeve themelues", me kerkuan redaktimin e ketij akti themelimi, nepermjet te cilit ata deklaruan se me vullnet te lire te plote e te sinqerte, mbeshtetur ne iniciativen e lire private, Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe kodin civil ne fuqi, ne ligjin nr.9901, date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", te ndryshuar me ligjin 129/2014, ne ligjin 9723, datë 3.5.2007 "Per Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", ne kodin doganor, fiskal e tatimor, per krijimin e shoqerise tregtare, me pergjegjesi te kufizuar, me emertimin: "SPA MILANO" sh.p.k.

KREU I

Emertimi, forma juridike, selia, kohezgjatja,objekti

Neni 1

Emertimi

Emertimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "SPA MILANO" sh.p.k..

Neni 2

Forma juridike

Shoqeria "SPA MILANO" sh.p.k., eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria"), e themeluar nga personat fizike te siperpermendur, te cilet nuk pergjigjen per detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Secili ortak gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne Tirane, me adresen: Rruga "Ismail Qemali", Hyrja I, Ap.28

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te asamblese se ortakeve.

Neni 4

Objekti

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj ushtrimin e aktiviteteve të mëposhtme:

- prodhimin dhe oferta per shoqerite, ndermarrjet, profesionisteve dhe personave fizike dhe juridike, publike dhe private, institucionet publike dhe lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, ekonomike ose jo,

M

shoqatave profesionale, organizatave jofitimprurëse, ndermarrjeve publike, private dhe te përziera, në çdo rast te themeluara, te shërbimeve te lidhura me veprimtarite e përpunimit të të dhënave kontabile, personale dhe jovepm, dhe te konsultimeve, përgatitja dhe paraqitja e praktikave te financimit bazuar në praktikat e ligjeve në fuqi, rajonale, kombëtare dhe te bashkimit evropian.

- profesionisteve dhe personave fizike dhe juridike, publike dhe private, institucionet publike dhe lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, ekonomike ose jo, shoqatave profesionale, organizatave jofitimprurëse, ndermarrjeve publike, private dhe te përziera, në çdo rast te themeluara te shërbimeve qe lidhen me menaxhimin, kërkimin dhe trajnimin e personelit nepermjet:

këshilla dhe ndihma në procedurat e kërkimit dhe përzgjedhjes se procedurave te personelit;

këshilla dhe ndihma në formimin profesional dhe menaxherial nepermjet veprimtarise teorike-praktike te mesimit, stërvitjes dhe ushtrimi;

organizim i kurseve te trajnimit profesional dhe praktikave, për llogari te ndermarrjeve, publike dhe private, institucionedve shkollore duke ndërmarre projektimin, mësimdhënien dhe organizimin e trajnimit te ndermarrjes;

organizimi i kurseve të formimit dhe trajnimit profesional për llogari te drejtuar direkt për individët, ndermarrjet dhe entet publike, edhe duke konsultuar burimet e fondeve sociale evropiane dhe perfshire edhe ato të vëna në dispozicion nga ndonjë institucion tjetër kombëtar apo ndërkombëtar;

organizimi i shkollave te formimit, organizimi i konferencave, seminareve, ngjarje kulturore, edhe përmes përdorimit të teknikave mësimore në distancë;

- prodhimin dhe oferta per shoqerite, ndermarrjet, profesionisteve dhe personave fizike dhe juridike, publike dhe private, institucionet publike dhe lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, ekonomike ose jo, shoqatave profesionale, organizatave jofitimprurëse, ndermarrjeve publike, private dhe te përziera, në çdo rast te themeluara, te shërbimeve të lidhura me drejtimin tekniko-administrativ, pasuror dhe financiar nepermjet:

ndihmave, konsulencave dhe të çdo aktiviteti tjetër qe lidhen me probleme te rendesishme te organizimit te ndermarrjes në çështjet e:

blerjeve; kontratave; operacioneve te import-eksportit; veprimtarive te kërkimeve dhe zhvillimeve; logjistikës dhe transportit; sistemit informativ te ndermarrjes; tregtise elektronike and risive teknologjike në fushën e informatikes dhe telematikes; çështjet mjedisore në pergjithesi, higjenes dhe sigurisë në vendin e punës, etj.;

këshilla dhe ndihma për përgatitjen dhe paraqitjen e praktikave të kërkimit për kredi, kredite nxitese dhe hipotekore, kredi personale dhe garantuesit, qirate, sigurimin e kolateralit reale apo personale. ndihmave, konsulencave dhe aktiviteteve të tjera te lidhura me dhënien e certifikimit të cilësisë; regjistrimi i shoqerive në regjistrin kombëtar; kryerjen e studimeve te marketingut, kerkime tregu, projektim dhe realizim te veprimtarive te reklamave, nxitja dhe mbështetja e imaxheve te shoqerise; projektimi, ndërtimi dhe drejtimi i kanaleve të shitjes, të rrjetit te ndermarrjes i specializuar në shitje, në komunikim, në marketing, ne zhvillimin e projekteve me me teper realitet sipërmarrës dhe çdo veprimtari tjetër te zhvilluar për të nxitur takimi midis kërkesës dhe ofertës;


ndihmave, kontrollit, realizimit te studimeve qe jane si ne interes te iniciativave te reja te ndermarrjes, ashru edhe te ndermarrjes ekzistuese nepermjet hartimit te planeve te biznesit, studimeve te fizibilitetit, vleresimve te mepareshmr per analizimin e mundesive te investimeve dhe ristrukturimit te ndermarrjes, financimin e projektit, kontrollit dhe monitorimit te planifikimit te shoqerise;

- rishikim dhe oranizim financiar (kontabel), sipas ligjit dhe ndonjë dispozitë tjetër te ligjit që rregullon këtë vit aktiviteti;

- prodhimin, përpunimin, tregtimin, shpërndarjen dhe drejtimin, te softwareve dhe hardwareve me asistencën teknike perkatese.

- dhenie me qira per te tretë dhe për vete pronarët, te pasurive të tundshme dhe te patundeshme, te regjistruara ne shoqeri, si ato pronesore ashtu dhe ato të disponueshme;

- prodhimin dhe oferta te shërbimeve në sektorin e turizmit, duke përfshirë drejtimin e strukturave akomoduese dhe plazhi.



- prodhimin dhe oferta te shërbimeve në industri, duke përfshirë menaxhimin e strukturave akomoduese. për të arritur objektivat dhe qëllimet sociale, shoqëria mund të bëjë veprimet e nevojshme nga ana e organeve administrative në fushën tregtare, industriale, financiare, te pasurive te lujtshme dhe te palujtshme, duke përfshirë lidhjen e kontratave me ndermarrjet dhe agjencite e ndermarrjeve, shoqëri financiare dhe te sigurimeve, perfshire paraqitjen e garancive reale ne favor te te treteve. Shoqëria mund të paraqese (marre), si ne menyre te drejteperdrejte dhe jo, interesat dhe pjesemarrjen ne shoqëri te tjera dhe ndermarrje, me objekt te njejte, per deri sa te jete e lidhur. Eshte e perjashtuar ushtrimi ne rruge profesionale te veprimtarise per ligje te rezervuara per profesioniste te regjistruar ne urdherin e profesionistit dhe ne veprimtari te rezervuara sipas ligjit per institutet e kreditit ose shoqëri te tjera financiare.

- konsulence dhe asistence ne fushen e veprimtarive te shoqërive, te zakoneshme dhe te jashtëzakonshme, si p.sh. konsulenca dhe asistenca ne fushen e veprimeve te perthithjes, ndarjes, blerjes te ndermarrjeve dhe degeve te tyre.

- konsulence dhe asistence kontabile, siscale, administrative, drejtuese dhe strategjike.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërise eshte 100.000 lekë, i perbere nga 2 kuota

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar dhe shlyer teresisht nga ortakët e shoqërise perkatesisht :

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar dhe shlyer tërësisht ne te holla nga ortakët e shoqërise:

1. Antonio MANCA, zoterues i 1 kuote, me vlere te pergjithshme 50.000 leke, qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqërise;
2. Giuseppe SPAGNOLO, zoterues i 1 kuote, me vlere te pergjithshme 50.000 leke, qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqërise;

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë të kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 7


Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave te treteve jashte shoqërise, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumices se cilesuar qe kerkon ndryshimi i statutit.



Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidarë ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi vendimmarres

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.


Neni 9

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, miratimin e bilancit, kontrollin e llogarive, miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë, riorganizimin, bashkimin ose ndarjen e shoqërisë, shnderimin në një formë tjetër, transferimin e kuotave, emërimin e ekspertëve dhe likuidatoreve dhe prishjen e shoqërisë, zhvillon mbledhje, të cilat janë të vlefshme, kur në të janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë me shume se gjysmën e numrit total të kuotave të kapitalit të shoqërisë të cilët votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 dhe merren vendime të vlefshme me votimin pro të $\frac{3}{4}$ të ortakëve pjesëmarrës.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, kur në të marrin pjesë ortakët me të drejtë vote të cilët zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) përcaktimin e shpërblimeve



d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursionit të veprimtarisë;

e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë Qendres Kombëtare të Regjistrimit për të pasyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 10

Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga një administrator. Administratori do të jetë Antonio MANCA dhe Giuseppe SPAGNOLO. Administratorët do të ushtrojnë detyrat e tyre sipas statutit dhe ligjit për një periudhë 5 vjeçare.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asamblesë së përgjithshme. Administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë asamblesën e përgjithshme për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.

Dorëheqja e administratorit nuk cenon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që administratori ka ndaj saj, sipas këtij ligji".

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administratori i shoqërisë mund të emerohet edhe një person jashtë ortakërisë.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

te kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm të veprimtarisë tregtare së shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga ortakët e vetëm,

b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecursionit të veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojë përpara ortakët në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori përfaqëson shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve, bankat e të gjitha niveleve, zyrtarët e tatimit taksave, doganave, zyrtarët e qeverisjes vendore etj.

Administratori nuk ka të drejtë të nënshkruaje kontrata huaje, hipoteke, pa marre me pare miratimin me shkrim të asamblese se ortakëve.

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e asamblese edhe ne rastet kur :

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të tij, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Neni 12

Viti financiar

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 dhjetor.

Neni 13

Prishja dhe likuidimi

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- c) në rast se objekti bëhet i porealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i këtij ligj;
- d) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
- dh) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
- e) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.

2. Prishja e shoqërisë, si pasojë e një apo më shumë prej shkaqeve të përcaktuara në shkronjat “a”, “c”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga asambleja e ortakëve me shumicën e parashikuar sipas pikës 1, të nenit 87, të ligjit 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqëritë tregtare”.

3. Në rast mosveprimi të asamblesë së ortakëve për të vendosur prishjen, për shkaqet e përcaktuara në shkronjat “a”, “c”, “d”, dhe “dh”, të pikës 1, të këtij neni, çdo person i interesuar mund, në çdo kohë, t'i drejtohet gjykatës për të konstatuar prishjen e shoqërisë.

4. Pavarësisht nga parashikimet e sipërpërmendura, ekzistenca e një a më shumë shkaqeve, të parashikuara nga shkronjat “a”, “c”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, nuk do të ketë si pasojë prishjen e shoqërisë dhe hapjen e procedurave të likuidimit, nëse përpara vendimit gjyqësor të formës së prerë, të përmendur në pikën 3, të këtij neni, shkak i prishjes është korrigjuar, nëse është e mundshme të korrigjohet, dhe ky korrigjim është publikuar nga shoqëria në regjistrin tregtar, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.


5. Prishja e shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente për procedurat e falimentimit, kur, në përfundim të këtyre procedurave, të gjitha pasuritë e shoqërisë janë likuiduar për shlyerjen në mënyrë kolektive të detyrimeve ndaj kreditorëve apo kur gjykata kompetente për procedurat e falimentimit vendos rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurisë së shoqërisë për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.

6. Prishja e shoqërisë si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën “ç”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve të nenit 3/1 të 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 14

Baza ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit



shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" ndryshuar me ligjin nr.129/2014, kodit civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 15

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 16


Dispozita perfundimtare

Autorizohet Altin CANEMETI, te depozitoje kete akt themelimi dhe statutin e shoqerise, prane Qendres Kombetare te Regjistrimit, si dhe te ndjeke te gjitha procedurat ligjore per regjistrimin e shoqerise.


Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe, dhe u perkthye ne gjuhen italiane per shtetasin italian nga perkthyes Jonida Kofina, miratohet ne parim dhe nen per nen nga ortakët themelues te shoqerise tregtare "SPA MILANO" sh.p.k., dhe nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale dhe une noterja vertetoj nenshkrimet e tyre sipas ligjit.

ORTAKET

Antonio MANCA



Giuseppe SPAGNOLO



NOTERE
Elmira KODRA

JONIDA KOFINA
PERKTHYESE

